

FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE (1912-1939)

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

ALBERT BRAHIMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

KORRIK, 2023

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

Mentori: *Prof. Ibrahim Gashi*

Kandidati: *Albert Brahim*

Tema: *Forcat e Armatosura Shqiptare (1912-1939)*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: “ Forcat e Armatosura Shqiptare (1912-1939)”. Për punimin e këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë konsultuar burimet të cilat kanë qenë të qasshme.

Punimi përmban katër kapituj:

- Në kapitullin e parë “**FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE 1912-1918**”, trajtohen vitet e para të fillimit të organizmit ushtarak shqiptar, pra me përpjekjet e qeverisë së Vlorës dhe faktorëve ndërkombëtarë. Duke shënuar edhe fillimin e institucionalizimit të ushtrisë shqiptare. Pastaj trajtohen formacionet shqiptare në kuadër të Luftës së Parë Botërore.
- Në kapitullin e dytë “**ORGANIZIMI USHTARAK SHQIPTAR 1918-1924**”, spikatin disa figura që dhanë kontribut në organizimin e Forcave të Armatosura, si Ali Riza Kolonja, Selaudin Shkoza e Ahmet Zogu. Ndërsa duhet përmendur edhe ngjarja e qershorit 1924, ku u implikuan edhe faktorët ushtarak për të rrëzuar qeverinë.
- Në kapitullin e tretë “**FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE NË KOHËN E REPUBLIKËS**”, trajtohet periudha republikane, ku fjalën kryesore e tha Ahmet Zogu, dhe rritja e ndikimi Italian, si dhe tentimet për reforma në ushtri të cilat hasën në vështirësi të shumta.
- Në kapitullin e katërt “ **FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE NË PERIUDHËN E MONARKISË**”, në këtë periudhë kemi, rritjen e mëtutjeshme të ndikimit italianë e cila po e hapte rrugën drejt pushtimit të Shqipërisë. Ahmet Zogu me titullin mbret mori edhe komandën e forcave të armatosura. Në këtë kohë në bazë të ligjit forca të armatosura

konsideroheshin: Policia dhe Ushtria, këto dy trupa në vitin 1939 përbënin një forcë rreth 13500 vetash në vitin 1939, pra forcë aktive.